



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 2269/9 Prot.

Pogradec, më 29.05 . 2026

VENDIM

NR. 65, DATË 28.05.2026

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 28.05.2026 TË  
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 30.03.2026, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 28.05.2026 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Albana PRIFTI



1. Miratuar me 21 vota

2. Vota Pro 21

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 28.05.2026

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

ORA : 12:00

JANË PREZENT 22 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC  
DATE 30.04.2026 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 30.03.2026.
3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimartjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.03.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për “Detajimin dhe përdorimin e fondit të Kushtëzuar për mbrojtjen civile 2026”
7. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e Planit Lokal të veprimt për Barazi , përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec (2026-2030)
8. **Projekt – Vendim:** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026”
9. **Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihmë financiare për znj.E.P.
10. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e zgjatjes të periudhës së ngrohjes në institucionet arsimore të Bashkisë Pogradec.
11. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e distancave sipas rrugëve të reja të transportit rrugor rrethqytetës të udhëtarëve dhe linjave të transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve të Bashkisë Pogradec, si dhe miratimin e linjës së re Lagjia Lazishtë Velcan- Shkolla Bishnicë për transport nxënës.
12. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM” SH.A tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e ekonomisë të mbetjeve” sha.



**13. Projekt – Vendim:**Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen antene të telefonisë të lëvizshme në favor të kompanive one Albania SH.A në sipërfaqe, 160 m2 në pasurinë 665 zk 2042 Kalivac, Trebinjë dhe Vodafone Albania SH.A sipërfaqen 100 m2 në pasurinë 213/6 zk 3753 Vërrri, Proptisht.

**14. Projekt – Vendim:**Për disa shtesa dhe ndryshime mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit taksi në Bashkinë Pogradec.

**15. Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga Shoqëria Pogradec Invest shpk.

**16. Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqëria Pogradeci Invest shpk, për vitin 2026.

**17. Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 8 Ha e 5543 m2 ,e ndodhur në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qira.

**18. Informacion nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukurës në lidhje me punën e kryer gjatë periudhës Janar-Prill 2026, sfidat, sukseset dhe planet në vazhdim për vitin 2026.**

**19. Të tjera.**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**Znj. Kryetare:** Jemi mbledhur sot në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, të njoftuar sipas ligjit nr. 139/2015, neni 53, pika 4. Ju lutem të verifikojmë prezencën.

**Znj. Bojko:** Janë prezent 22 këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.**

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me rendin e ditës. Ju bëj me dije se, me vendim të Kryesisë, projektvendimi nr. 7 kalon për konsultim publik. Gjithashtu, edhe projektvendimet nr. 14 dhe nr. 17 kalojnë për konsultim publik. Atëherë, nëse jemi dakord dhe nuk ka diskutime për axhendën, e hedhim në votim.

**Vjen Albana Prifti Ora 12:05**

**U votua**

**Pro 23**

**Kundër 0**

**Abstenim 1 (E.Mancellari)**

**Miratohet Po Jo**



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

2. Projekt – Vendim :Miratimi i Procesverbalit të datës 30.03.2026.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë atëherë me pikën e dytë të rendit të ditës. Nëse jemi dakord, e hedhim në votim. Ju lutem.

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.**

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. E kemi shënuar në axhendë për të mos harruar që këshilltarët të shprehin konfliktin e interesit, nëse ka. Çdokush është i lirë të deklarojë konfliktin e interesit.

**Z. Shyti:** Deklaroj konflikt interesit për pikat 15 dhe 16.

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Z. Shyti', located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.03.2026.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Lexohet konfirmimi nga Prefektura.

Vjen Znj.Shuli Ora 12:17

A handwritten signature in black ink, appearing to be the initials 'J.B.' or similar, located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**5. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2026.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës. A kemi diçka, të nderuar kolegë?

**Znj. Luljeta:** Ju lutem, një sqarim. Për muajin mars 2026 janë rekomanduar rreth 20 familje. Procedura është po e njëjtë.

**Znj. Kryetare:** A kemi diçka tjetër? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është dakord?

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



**6. Projekt – Vendim:** Për “Detajimin dhe përdorimin e fondit të Kushtëzuar për mbrojtjen civile 2026”

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e radhës. Ju lutem, një informacion nga Z. Torra.

**Z. Torra:** Pranë Bashkisë së Pogradecit kanë ardhur shkresat përkatëse. Në relacionin që kam dërguar për projektvendimin, kemi vendosur që fondi të shpërndahet për familjet sipas radhës kronologjike të ndodhjes së fatkeqësisë.

Kuptohet që fondi duhet të jetë më i madh, pasi kjo shumë nuk e përballon vlerën totale, e cila është rreth 11 milion lekë. Me çeljen e pjesës tjetër të fondit, ai do të përdoret vetëm për shlyerjen e familjeve të dëmtuara.

Shuma aktuale në dispozicion nuk e përballon të gjithë vlerën, por pagesat do të bëhen sipas radhës dhe kronologjisë së ndodhjes së fatkeqësisë.

**Znj. Kryetare:** E diskutuam edhe në komision. Është mirë që të shtohet në relacion se pagesa do të bëhet sipas radhës, në mënyrë që të jetë e qartë.

**Z. Hazhillari:** Ne si komision duhet ta sqarojmë që të ndiqet një kriter, meqenëse fondet nuk i përmbushin të gjithë të dëmtuarit. Kriteri është sipas datave, siç u theksua.

**Znj. Kryetare:** Kush është dakord? E hedhim në votim.

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



**7. Projekt – Vendim:** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 101, datë 31.10.2025 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026”

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Ia japim fjalën Znj. Enjela.

**Znj. Enjela:** Në hartën që kemi miratuar janë përcaktuar vetëm vijëzimet se ku do të ndalojnë varkat me motor uji. Në bazë të kërkesave që na kanë ardhur nga disa individë, janë vendosur trevendbazime, të cilat janë pozicionuar në dy krahët e dy urave dhe një tek motorpompën, në fund. Kjo bëhet për të mundësuar ndalimin e tyre, pasi policia kufitare nuk i lejon të ndalojnë në çdo vend sipas dëshirës, por duhet të jenë të përcaktuara.

**Znj. Kryetare:** Hartat janë të bashkëlidhura në projektvendim. Pra, bëhet fjalë për tre vende, tre pozicione për vendparkim.

**Znj. Kryetare:** Kush është dakord? E hedhim në votim.

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



8. Projekt – Vendim: Për dhënie ndihmë financiare për znj.E.P.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e radhës. I urojmë një shërim të shpejtë. E kemi vendosur me initiale për të ruajtur anonimitetin. Materialet i keni secili përpara. Bëhet fjalë për një arsye shëndetësore, ndaj edhe njëherë i urojmë shërim sa më të shpejtë. Besoj se nuk ka diskutim.

E hedhim në votim. Ju lutem, kush është dakord?

Pro	25
Kundër	0
Abstenim	0

Miratohet Po Jo



**9. Projekt – Vendim:** Për miratimin e zgjatjes të periudhës së ngrohjes në institucionet arsimore të Bashkisë Pogradec.

**Znj. Kryetare:** Të gjithë e kemi ngritur këtë shqetësim. E kanë ngritur edhe prindërit, edhe nxënësit, ashtu siç e shohim edhe në relacion, si dhe kolegët e nderuar.

**Znj. Biba:** Faleminderit. Po flas për situatën konkrete. Nëse vini sot në shkollën tonë, është ftohtë. Edhe pse zgjatja u realizua për muajin prill, përsëri mbetet ftohtë. Ne kemi mundësi të ndezim ngrohjen, por kur kemi kërkuar nga institucionet, na është kthyer përgjigjja se ka një afat të përcaktuar dhe nuk mund të ndizet jashtë këtij afati, nëse nuk ka një udhëzim të posaçëm.

**Znj. Kryetare:** Duhet të merret një specialist për ta përcaktuar këtë.

**Z. Kryetari:** Ne e kemi realizuar dhe janë dhënë urdhra që ngrohja nëpër shkolla të ndizet sa herë që është e nevojshme.

**Znj. Kryetare:** Patjetër, por duhet të përcaktohet mënyra. Duhet të vendoset një temperaturë minimale, ku ambienti i brendshëm të jetë në një nivel të caktuar.

**Znj. Biba:** Mjafton që të ketë karburant të mjaftueshëm.

**Znj. Prifti:** Duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë për vitin tjetër dhe të shihet me më shumë prioritet, pasi Pogradeci është vend i ftohtë. Nuk është e tolerueshme që fëmijët të kenë ftohtë gjatë gjithë vitit.

**Znj. Kryetare:** Ju lutem të respektojme njëri-tjetrin. Duhet një specialist për ta përcaktuar këtë. Nuk mund ta lëmë vendimin në mënyrë subjektive. Duhet të përcaktohet një kufi temperature, ku nëse bie nën atë nivel, të ndizet ngrohja. A ka ndonjë specialist prezent për ta përcaktuar?

**Z. Babasuli:** Më falni, por përcaktimi nuk mund të bëhet në këtë mënyrë. Mendoj që duhet të vendoset një afat dhe të bëhet një vlerësim mesatar, pasi nuk mund të bazohemi vetëm në temperaturë momentale.

**Znj. Kryetare:** E kalojmë në votim, ashtu siç është në projektvendim.

Vjen Z.Qeva Ora 12:25

Pro 26  
Kundër 0  
Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**10. Projekt – Vendim:** Për miratimin e distancave sipas rrugëve të reja të transportit rrugor rrethqytetës të udhëtarëve dhe linjave të transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve të Bashkisë Pogradec, si dhe miratimin e linjës së re Lagjia Lazishtë Velcan- Shkolla Bishnicë për transport nxënës.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Kolegë, ju lutem, mos i mbyllni mikrofonat. Ia japim fjalën Z. Shtupa.

**Z. Shtupa:** Drejtoria Arsimore kërkon vazhdimisht miratimin e linjave të reja për nxënësit, shtesa apo ndryshime të distancave sipas shkollave, për transportin e nxënësve dhe mësuesve. Në vendimin e vitit 2024 është bërë miratimi i të gjitha linjave, distancave dhe tarifave. Kërkesa e Drejtorisë Arsimore është që të bëhet një shtesë për transportin e nxënësve në pjesën e sipërme të Velçanit, ku distanca ishte 5 kilometra. Kjo shtesë do të konsiderohet si linjë e re për nxënësit. Sa i përket distancës, kërkesa është që të përcaktohet në bazë të rrugës së re në Mokër. Matja është bërë për të përcaktuar sa më saktë distancën dhe kategoritë e rrugës. Nëse ka ndonjë pyetje, jam i gatshëm.

**Znj. Kryetare:** Kolegë, a kemi pyetje? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është dakord?

Pro 26

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



**11. Projekt – Vendim:** Për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM” SH.A tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e ekonomisë të mbetjeve” sha.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Ju faleminderit. Ia japim fjalën Znj. Erinda.

**Znj. Erinda:** Përshëndetje të gjithëve. Po ju paraqis sot projektvendimin, i cili parashikon një unifikim vendimmarrjeje për kthimin e AK SH.A. si një shoqëri 100% shtetërore.

**Znj. Kryetare:** Edhe ne, si Këshill, kemi marrë një shkresë për shkak të ndryshimeve ligjore. Atëherë, I japim të drejtën Kryetarit të na përfaqësojë.

**Z. Pikuli:** Kur ka ardhur kjo shkresë?

**Znj. Kryetare:** Po ju lexoj shkresën.

**Z. Pikuli:** Kjo do të thotë që është miratuar?

**Znj. Kryetare:** Shkresa është njoftim për miratim. Na njoftojnë në bazë të kuadrit ligjor.

**Z. Kryetari:** Aksionerë kemi qenë dhe mbetemi.

**Z. Pikuli:** Nuk është problem kjo pjesë. Pyetja është: a do të përmirësohet vërtet shërbimi?

**Z. Kryetari:** Kjo nuk varet nga ne.

**Z. Pikuli:** Pa bërë një analizë se si do të funksionojë, mua më intereson mënyra e shërbimit. Nëse të gjitha mbetjet do të shkojnë në Tiranë, atëherë a do të përmirësohet ky shërbim? Nga eksperiencia që kemi, e dimë shumë mirë që këto lëvizje nuk kanë funksionuar. Kush na siguron ne, si Këshill Bashkiak i Pogradecit, që kjo do të funksionojë?

**Z. Kryetari:** Deri tani si ka funksionuar dhe si ka qenë, pritet të përmirësohet. E hedhim në votim.

**Znj. Kryetare:** Po krijojmë një debat të pavend. Shkresa ka ardhur për shqyrtim.

**Z. Kryetari:** Ne mendojmë për më mirë.

**Z. Pikuli:** Ne duam argumente pse mendoni që është për më mirë. Nëse është për më mirë, urime.

**Z. Kryetari:** Duhet të shohim edhe mundësinë tonë. A kemi mundësi ta bëjmë në Pogradec? Nuk na detyron askush, por ne nuk e kemi mundësinë. Shpenzimet janë shumë të larta, rreth 220 mijë euro në vit.



**Z. Pikuli:** Ne duam vetëm të dimë nëse do të përmirësohet.

**Znj. Kryetare:** A ka dëshirë të flasë dikush tjetër? Nëse jo, e hedhim në votim.

**Pro** 20

**Kundër** 4 (A.Prifti, F.Pikuli, K.Gjona, M.Biba)

**Abstenim** 2 (A.Male, E.Mancellari)

**Miratohet** Po Jo

A handwritten signature in black ink, appearing to be the name 'Juf' followed by a stylized flourish.

**12. Projekt – Vendim:** Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen antene të telefonisë të lëvizshme në favor të kompanive one Albania SH.A në sipërfaqe, 160 m2 në pasurinë 665 zk 2042 Kalivac, Trebinjë dhe Vodafone Albania SH.A sipërfaqen 100 m2 në pasurinë 213/6 zk 3753 Vërrri, Proptisht.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e radhës. Kishte kolegë që ishin edhe në konsultimin publik që u zhvillua në dy fshatra. Banorët e dëshirojnë, pasi është në të mirën e tyre.

**Z. Kryetari:** Kompanitë përkatëse e kanë për detyrë që në zonat ku operojnë të kontribuojnë në të mirë të komunitetit.

**Znj. Kryetare:** Ia japim fjalën Z. Xhyra.

**Z. Xhyra:** Konsultimi u bë me sukses. Të gjithë banorët ishin dakord në të dyja fshatrat ku ne morëm pjesë. Ata vetë e kanë kërkuar, me përjashtim të një banori që paraqiti shqetësim, pasi ishte pronar i një pjese toke.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim. Kush është dakord?

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 1 ( E.Mancellari)

Miratohet Po Jo



**13.Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga Shoqëria Pogradec Invest shpk.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën tjetër. Pika 14, ashtu siç e përmendëm, kalon për konsultim publik. Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

**Z. Cela:** Përshëndetje. Kemi sjellë dy projektvendime.

**Znj. Kryetare:** T'i marrim me radhë, të lutem.

**Z. Cela:** Sa i përket administrimit të pallateve, aktualisht kemi vetëm shërbimin që kryejmë për pallatet ku banorët na kanë zgjedhur. Tarifa mbetet e njëjtë.

**Znj. Kryetare:** Me radhë, jemi tek administrimi i pallateve.

**Z. Cela:** Për pjesën e ashensorëve nuk kemi filluar ende, për arsye se nuk kanë dalë aktet nënligjore. Kemi kërkuar informacion nga kompanitë që operojnë aktualisht dhe presim përgjigjen e tyre. Shërbimi duhet të vazhdojë, sepse banorët e kërkojnë dhe ne do të vazhdojmë siç kemi qenë deri tani. Tarifa është 500 lekë në muaj për familje dhe nuk ka asnjë ndryshim në pagesë.

**Z. Kryetari:** Për pallatet që nuk kanë administrim, si e keni menduar?

**Z. Cela:** Ne jemi një shoqëri administrimi dhe shkojmë në çdo pallat ku kemi konfirmimin nga banorët.

**Z. Kryetari:** Mund të mblidhen 10–15 pallate dhe zgjidhjen ta bëjnë vetë.

**Z. Cela:** Ligji është i qartë. Nëse banorët nuk arrijnë të ngrenë kryesinë, në rastin konkret vendosni ju si Kryetar Bashkie dhe përcaktoni kush do të administrojë.

**Z. Kryetari:** Ju duhet t'i kishit vendosur këto.

**Z. Cela:** Po, por ende nuk kanë dalë aktet nënligjore, prandaj ndodhemi në këtë situatë.

**Znj. Silvana:** Më falni, por në një pallat të ri jetojnë vetëm 4 familje. Me familjet e tjera si do të procedohet?

**Z. Cela:** Nuk ka rëndësi, pasi shërbimi do të kryhet njësoj si për ata që janë prezent, ashtu edhe për ata që nuk janë. Brenda vitit ata do të kthehen, por kanë detyrim ligjor që pagesa duhet kryer.



Bashkia thjesht ndihmon situatën në momente të vështira për shoqërinë, ndërsa detyrimet do të paguheshin ose nga vetë familjet, ose nëpërmjet bankës.

**Z. Kryetari:** Mirë do të ishte të gjenim një zgjidhje, ose me ujësjellësin, ose me energjinë elektrike.

**Z. Babasuli:** Ligji parashikon që, në mungesë të banorëve, nëse brenda vitit ata nuk paraqiten, ekziston e drejta që të vendoset barrë detyrimi në hipotekë për detyrimet e pallatit. Në momentin kur pallati nuk përzgjedh një kryesi, këtu ndërhyjnë bashkia dhe e zgjidh situatën, por aktualisht kemi problemin e akteve nënligjore që ende nuk kanë dalë. Për sa i përket kostove aktuale, është bërë një parashikim dhe jemi në rregull. Bëhet fjalë për pallatet pa ashensor. Për pallatet me ashensor do të kemi një fazë të dytë. Edhe për pjesën e ashensorëve do të rikthehemi me një fazë tjetër, pasi jemi në diskutim me kompanitë operuese për mënyrën e procedimit.

**Z. Cela:** Disa pallate që i kemi aktualisht në administrim janë shumë të kënaqur. Banorët kanë ardhur në zyrë dhe po na kërkojnë përsëri për administrim. Në çdo rast që ata nuk janë dakord me punën tonë, ne largohemi dhe ata kanë të drejtë të zgjedhin shoqërinë që dëshirojnë.

**Znj. Biba:** Mesa di unë, janë edhe dy shoqëri të tjera. Si do të operoni?

**Z. Cela:** Duhet të ngrihet kryesia, e cila përbëhet nga tre persona, dhe në momentin që ata na zgjedhin ne, bëjmë kontratën. Çdo shqetësim që ata kanë, ne mundohemi ta zgjidhim dhe deri tani çdo problematikë është trajtuar në kohë.

**Znj. Biba:** Shumë pallate, kur dëgjojnë për projektvendimet, pyesin për procedurat.

**Z. Cela:** Ne nuk mund të shkojmë pa u ngritur më parë kryesia dhe të ofrojmë shërbim.

**Z. Babasuli:** Më falni, nëse kryesia e pallatit ka zgjedhur "Pogradeci Invest", atëherë shoqëria ka të drejtë të kryejë shërbimet. Problemi mbetet tek ato pallate që kanë pak familje dhe nuk mund të ngrenë kryesinë. Në atë rast, kompetencat i kalojnë bashkisë dhe më pas bashkia përcakton kompaninë që do të merret me mirëmbajtjen e pallatit. Aktualisht jemi në fazat e para dhe kemi rreth 27 godina, ndërkohë që në total janë 105 pallate me ashensor. Kemi tentuar të mësojmë edhe pjesën e ashensorëve. Jemi ende në proces përmirësimi dhe po trajtohen një nga një. Jam i sigurt që situata do të përmirësohet dita-ditës. Nëse ka shqetësime për pjesën e administrimit, duhet të përshpejtojmë edhe procedurat.

**Z. Cela:** Informacionet janë dhënë, si edhe numri i telefonit. Banorët kanë ardhur edhe në zyrë dhe janë informuar gjerësisht. Gjithashtu do të dalim edhe me një njoftim tjetër.

**Z. Kryetari:** Ndoshta duhet të bëni mbledhje dhe t'i informoni. Kjo duhet bërë.

**Z. Cela:** Kemi bërë njoftime në çdo pallat, por ka raste kur banorët nuk pranojnë, pasi e pastrojnë vetë shkallën. Ndërkohë, pa dalë aktet nënligjore, ne nuk mund të veprojmë më tej. Aty ku ka pasur raste konkrete dhe kanë kërkuar shoqërinë tonë, ne u jemi përgjigjur.



**Znj. Seitllari:** Kam të njëjtin shqetësim. Kemi nevojë për më shumë informacion lidhur me kërkesat dhe çfarë shërbimesh do të ofroni konkretisht.

**Z. Cela:** Në fillim paraqitet kërkesa dhe më pas kërkohet administrimi. Ideja është që, pa na zgjedhur ne, nuk mund t'u përgjigjemi apo të tregojmë konkretisht çfarë mund të bëjmë. Brenda 6 muajve, nëse ne nuk ofrojmë shërbimin e duhur, ata kanë të drejtë të zgjedhin një kompani tjetër. Por pa administrim nuk mund të qëndrohet, sepse është detyrim ligjor.

**Z. Gjona:** Ky projektvendim ka ardhur edhe më parë dhe arsyeja kryesore që nuk kaloi ishte mungesa e akteve nënligjore. Ato kanë dalë tani?

**Z. Cela:** Aktet nënligjore ende nuk kanë dalë, por ne duhet të vazhdojmë punën me kuadrin aktual dhe më pas do të merremi me pjesën tjetër.

**Z. Babasuli:** Duhet të jetë tarifa e aprovuar.

**Z. Gjeno:** Kisha një pyetje për pallatet që nuk kanë ashensor. Si mund të veprohët?

**Z. Cela:** Aty ku ne jemi në administrim, bëjmë projektin, e paraqesim në urbanistikë, bëhet konfirmimi dhe, nëse ka mundësi teknike, realizohet.

**Z. Babasuli:** Këtë investim mund ta bëjë edhe vetë banori, nuk e ndalon askush. Nuk është pjesë e administrimit vendosja e ashensorit. Detyrimi ynë është mirëmbajtja, pastërtia dhe funksionimi i tij. Kjo kosto nuk parashikohet në administrimin e pallatit, sepse vendosja e ashensorit është zgjedhje e vetë banorëve.

**Z. Mancellari:** Nga eksperiencia, kjo është diçka shumë e domosdoshme për komunitetin. Përveç orarit zyrtar, duhet të jeni në dispozicion të banorëve dhe të përgjigjeni për problematikat, sidomos në periudhën e dimrit, kur nevojiten shërbime shtesë. Gjithashtu, për familjet me një ose dy persona, si do të jetë pagesa? A do të jetë fikse apo më e ulët?

**Z. Babasuli:** Kjo mbetet për t'u diskutuar. Qëllimi i "Pogradeci Invest" është të kemi pallate të pastra, të ndriçuara dhe ashensorë funksionalë. Në momentin që do të kemi kostot reale, mund të kërkojmë tarifa më të ulëta për kategori të ndryshme. Ende nuk kemi bërë një kalkulim për tarifën e diferencuara, por kjo do të trajtohet në një fazë tjetër.

**Z. Mancellari:** Mendoj që kjo duhet parë që në fillim, në mënyrë që të gjithë të jenë të informuar. Një pension i dalë para vitit 2000 nuk është më shumë se 18 mijë lekë të reja dhe me atë shumë është e vështirë të përballohen tarifën. Duhet të ketë një tarifë minimale, për shembull 200 lekë në muaj.

**Z. Babasuli:** Siç e thamë, kjo do të vijë si pasojë e punës në vazhdim.



**Z. Cela:** Nga banorët që kemi pasur deri tani, shumica thonë: “Vetëm të mirëmbahen dhe jemi gati të paguajmë edhe pak më shumë”.

**Z. Pikuli:** A keni ndonjë pasqyrë financiare të “Pogradeci Invest”? Nëse po, vendoseni në dispozicion. Është një alternativë për qytetarët dhe duhet të dimë nëse banorët janë të kënaqur. Gjithashtu, nëse ka kontrata, sillini për shqyrtim.

**Z. Haxhillari:** Na ka ardhur një projektvendim për miratimin e tarifave të administrimit. Kjo shoqëri ende nuk është e kompletuar për mënyrën se si do të funksionojë. Pasi ta miratojmë dhe të fillojë puna, më pas do të kërkojmë llogari për rezultatet dhe mënyrën e funksionimit.

**Z. Male:** A jeni të gatshëm të sillni një pasqyrë financiare mes të ardhurave dhe shpenzimeve? Pra, a arrin “Pogradeci Invest” të mbulojë shpenzimet e veta apo vazhdon të marrë financime nga bashkia?

**Z. Cela:** Pasqyrën financiare e kemi. Në momentet kur kemi pasur vështirësi financiare, normalisht kemi marrë ndihmë nga bashkia. Në vitin 2025 kemi marrë rreth 5 milion lekë të reja.

**Z. Male:** Atëherë jeni me bilanc negativ. Për çfarë i duhet Pogradecit një shoqëri që rëndon mbi taksat e qytetarëve? Për sa vite mendoni se do të arrini të balanconi situatën?

**Z. Cela:** Ju garantoj që këtë vit nuk do të jemi të varur nga bashkia.

**Z. Kryetari:** Ne fillimisht e krijuam për parkimet, për të vendosur rregull. Ndërkohë po i japim edhe këtë mundësi.

**Znj. Prifti:** Dy herë në javë pastrim nuk mjafton. Në apartamentet ku jetojmë, edhe një llambë kërkon kohë për t’u ndërruar. Gjithashtu, lyerja është përcaktuar një herë në dy vjet, ndërsa pastrimi duhet të jetë të paktën katër herë në javë.

**Z. Cela:** Prandaj ekzistojnë disa kompani. Nëse një kompani tjetër ofron pastrim tre apo katër here në javë, normalisht banorët do ta zgjedhin atë. Por aktualisht kjo është mundësia jonë.

**Znj. Kryetare:** Atëherë, kolegë, e hedhim në votim. Kush është dakord?

**Pro** 18

**Kundër** 4 (L.Seitllari,A.Male,K.Gjona,A.Prifti)

**Abstenim** 3 ( E.Mancellari, F.Pikuli, M.Biba)

**Miratohet** Po **Jo**



14. Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqëria Pogradeci Invest shpk, për vitin 2026.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

**Z. Male:** Ky projektvendim, pak a shumë, është i njëjtë me atë që sollët herën e parë, për të cilin ne votuam kundër dhe patëm një dakordësi mes nesh. Mendoj se ky projektvendim është i dëmshëm për qytetin tonë dhe do të krijojë problem për qytetarët. Rritja e tarifave në rrugët kryesore do të bëjë që qytetarët të dynden në rrugët dytësore dhe ne e dimë shumë mirë si janë lagjet e Pogradecit. Ky është argumenti i parë. Së dyti, këtë rritje do ta vuajnë banorët e njësive administrative, sepse nga njëra anë nuk kanë të drejtë të parkojnë në lagje pasi nuk janë rezidentë, ndërsa nga ana tjetër parkimi me 100 lekë ora do të thotë një kosto prej rreth 500 lekësh të reja për mbi 5 orë qëndrimi në Pogradec, gjë që është relativisht e lartë. Së treti, si do t'i presim turistët? Korça aktualisht e ka parkimin 100 lekë dita. Një turist që qëndron 24 orë do të paguajë 2400 lekë parkimin dhe 3000 lekë hotelin.

**Z. Cela:** Nuk funksionon në këtë mënyrë. Orari është nga ora 08:00 deri në 18:00.

**Z. Male:** Sa orë janë? Tetë orë.

**Z. Cela:** Më fal, por kur shkon me pushime, nuk paguan parkim?

**Z. Male:** Po, por paguaj 200 lekë nata.

**Z. Cela:** Edhe këtu paguhet, ndërsa në disa hotele parkimi ofrohet falas. Nuk më rezulton që në ndonjë vend parkimi të jetë 200 lekë. Gjithashtu, ka edhe keqinformim, sepse rritja është sezonale, nga 15 qershori deri më 15 shtator.

**Z. Male:** Si do ta disiplinoni ju trafikun?

**Z. Cela:** Ky është disiplinimi. Bëhet fjalë vetëm për një rrugë kryesore dhe jo për të gjithë qytetin. Vetëm një rrugë do të jetë me pagesë, ndërsa pjesa tjetër mbetet siç ka qenë.

**Z. Male:** E dini çfarë ngarkese do të ketë ajo rrugë? Të gjithë do të dynden nëpër lagje. Pse nuk funksionon pulla e rezidentit?

**Z. Cela:** Ai që ka pullë rezidenti nuk do të paguajë.

**Z. Male:** Mendoj se kjo shoqëri nuk i duhet Pogradecit. Punën e bën policia bashkiake dhe policia e shtetit. Mos e përdorni si argument disiplinimin e trafikut, sepse Pogradeci është qytet i vogël dhe të gjithë njihen me njëri-tjetrin. E kam ngritur edhe tre muaj më parë shqetësimin për parkimet e zëna në mënyrë abuzive. Çfarë masash keni marrë si shoqëri për këtë problematikë?

**Z. Cela:** Duhet të paraqitet shqetësimi konkret. Aktualisht janë rreth 60 parkime që janë paguar.

**Z. Male:** Për kohëzgjatjen, si e keni menduar?

**Z. Cela:** Me këtë projektvendim që kemi sjellë, nëse parkimin e dëshironi nga e hëna në të premte, tarifa mbetet 36 mijë lekë, siç ka qenë. Nëse e dëshironi 24 orë, nga e hëna deri të hënën tjetër, tarifa është 72 mijë lekë. Gjithashtu, kemi parashikuar edhe tarifa 6-mujore për banorët që kanë kërkesa sezonale, jo për bizneset. Kjo është sqaruar qartë.

**Znj. Kryetare:** Unë personalisht, kolegë, do t'ju bëja thirrje të merrni pjesë në komisione. Këtë herë kishte shumë pak pjesëmarrje në komisione, ndërkohë që aty jepen mendimet dhe zhvillohen diskutimet kryesore. Ka shumë detaje që diskutohen në komisione. Ju lutem, merrni pjesë dhe mbani përgjegjësi.

**Z. Male:** Kjo do të thotë që nuk duhet të flasim?

**Znj. Kryetare:** Jo, nuk do të thotë që nuk duhet të flisni, por jo kaq gjatë dhe jo me kaq shumë detaje. Detajet diskutohen në komisione.

**Z. Mancellari:** Nëse bëhet fjalë për dy rrugët që kanë fluksin më të madh në qytetin e Pogradecit dhe pagesa do të jetë 100 lekë, do të sugjeroja që të shtohet për turistët, por me kusht që qytetarët e Pogradecit të mos paguajnë. Gjithashtu, do të donim një hartë të qartë ku të përcaktohen rrugët dhe zonat publike e private. Pse të mos përfshihen edhe Tushemishti, pjesa e liqenit në Starovë apo Lin, pasi edhe ato zona kanë fluks? Unë jam dakord ta votoj këtë projektvendim, por me kusht që qytetarët e Pogradecit të mos kenë pagesë.

**Znj. Zhaneta:** Kemi diskutuar vazhdimisht edhe në komisione që rruga industriale të mos preket, pasi është shumë e mbingarkuar nga trafiku. Shqetësimi është që të mos ketë parkime në atë aks dhe rruga të funksionojë me dy kalime, në të mirë të qytetarëve.

**Z. Cela:** Edhe unë e kam kërkuar këtë. Deri në momentin që rruga është me një kalim, mund të ketë parkim, por në momentin që bëhet me dy kalime, nuk mund të ketë parkim.

**Znj. Kryetare:** E diskutuam edhe herën e kaluar. Ju lutem, të mos përsërisim të njëjtat diskutime.

**Znj. Shuli:** Ju përshëndes të gjithëve. Ne jemi të detyruar të paguajmë shërbimet, pasi është një shërbim që paguhet kudo. Jam dakord me atë që tha Z. Mancellari, që të përfshihen edhe zonat e tjera turistike, si Tushemishti apo Lini, dhe parkimet të jenë me tarifë 50 lekë. E vetmja gjë që më shqetëson është se kam marrë telefonata nga bizneset lidhur me faktin që tarifa e bizneseve është e njëjtë me atë të hoteleve. Hotelet paguajnë një numër të konsiderueshëm punonjësish, por edhe bizneset kanë shpenzime të ngjashme. Si është bërë kjo ndarje? Vitin e kaluar tarifa ka qenë 36 mijë lekë të reja për gjithë vitin, ndërsa sivjet rritet me 100%. Në relacion thuhet se fundjavat përjashtohen, ndërkohë që bizneset punojnë pikërisht në fundjavë. Për mua kjo duhet të



rishikohet dhe të lihet siç ka qenë. Kjo është edhe kërkesa e bizneseve, të cilat shprehen se nuk kanë qenë në dijeni gjatë konsultimit publik.

**Znj. Kryetare:** Njoftimi është bërë edhe në faqen e Këshillit.

**Znj. Shuli:** Jo të gjithë janë të orientuar me rrjetet sociale.

**Z. Cela:** Ashtu siç kanë operuar edhe qytetet e tjera në Shqipëri, shërbimi nuk mund të jetë i njëjtë në çdo rast. Qyteti duhet të ketë akses dhe biznesi e përdor parkimin gjatë gjithë ditës. Pas orës 18:00 parkimi lirohet.

**Znj. Shuli:** Nuk jam kundër rritjes, por rritja duhet të jetë graduale dhe jo progresive.

**Z. Babasuli:** Ekziston edhe tarifa 6-mujore, e cila është kërkuar kryesisht nga hotelet.

**Znj. Shuli:** Tarifat janë të ndara në grafik.

**Z. Babasuli:** Kështu funksionojnë parkimet, të ndara sipas kategorive. Nuk e bëjmë ne këtë ndarje, është mënyra standarde e funksionimit.

**Z. Cela:** Në rastin konkret, shëtitörja funksionon me pagesë deri në orën 18:00.

**Znj. Kryetare:** A ka dikush tjetër që dëshiron të flasë? Kolegë, të sqarojmë diçka që të mos ketë dezinformim. Tarifat janë lexuar dhe hartat janë të bashkëlidhura. E kam kërkuar edhe herën e kaluar që të jemi të qartë.

**Z. Gjona:** Do të risjell shembullin që përmenda edhe herën e parë. Një familje pogradecare paguan rreth 150 mijë lekë të vjetra për shërbimet që ofron bashkia dhe duhet të paguajë edhe 360 mijë lekë parkim. Kjo është ajo që po miratojmë sot. Së dyti, unë jam nga ata banorë që vijnë nga rrethinat dhe punojnë në Pogradec. Edhe tarifa 50 lekë është problem për ne, pasi aq janë pagat, jo më të bëhet 100 lekë. Ju bëj thirrje që të mos e kalojmë këtë projektvendim.

**Z. Babasuli:** Ne nuk kemi vetëm parkime me pagesë, por edhe parkime pa pagesë. Kjo do të thotë që po përpiqemi të disiplinojmë situatën. Ai që ka mundësi, zgjedh parkimin me pagesë. Nuk mund të ketë parkim falas para çdo biznesi.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim. Kush është dakord?

**Znj. Kryetare:** Vetëm një gjë do t'ju kërkoja: të lajmërohen banorët, të afishohen tabelat dhe të jepet informacioni i nevojshëm.

**Pro** 18

**Kundër** 4 (L.Seitllari,A.Male,K.Gjona,A.Prifti)

**Abstenim** 2 ( E.Mancellari, F.Pikuli, M.Biba)

Miratohet Po Jo

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

15. Informacion nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukurës në lidhje me punën e kryer gjatë periudhës Janar-Prill 2026, sfidat, sukseset dhe planet në vazhdim për vitin 2026.

Znj. Kryetare: Gjithashtu, kemi kërkuar nga ndërmarrja të paraqesë informacion mbi punën e kryer për periudhën janar-prill 2026, pasi kolegët kanë pasur kërkesa dhe ankesa.

E deklaroj mbledhjen të mbyllur. Ju faleminderit.

Protokolli:

Suela Merikola



Mincato

Sekretare e Këshillit

Jona Bojko



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

ORA : 12:00

JANË PREZENT 22 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC  
DATE 30.04.2026 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 30.03.2026.
3. **Deklarimi I konfliktit të interesit** nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
4. **Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit** për mbledhjen e datës 30.03.2026.
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Për “Detajimin dhe përdorimin e fondit të Kushtëzuar për mbrojtjen civile 2026”
7. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e Planit Lokal të veprimit për Barazi , përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Bashkinë Pogradec (2026-2030)
8. **Projekt – Vendim:** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026”
9. **Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihmë financiare për znj.E.P.
10. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e zgjatjes të periudhës së ngrohjes në institucionet arsimore të Bashkisë Pogradec.
11. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e distancave sipas rrugëve të reja të transportit rrugor rrethqytetës të udhëtarëve dhe linjave të transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve të Bashkisë Pogradec, si dhe miratimin e linjës së re Lagjia Lazishtë Velcan- Shkolla Bishnicë për transport nxënës.
12. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM” SH.A tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e ekonomisë të mbetjeve” sha.



**13. Projekt – Vendim:**Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen antene të telefonisë të lëvizshme në favor të kompanive one Albania SH.A në sipërfaqe, 160 m2 në pasurinë 665 zk 2042 Kalivac, Trebinjë dhe Vodafone Albania SH.A sipërfaqen 100 m2 në pasurinë 213/6 zk 3753 Vërrri, Proptisht.

**14. Projekt – Vendim:**Për disa shtesa dhe ndryshime mbi mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit taksí në Bashkinë Pogradec.

**15. Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga Shoqëria Pogradec Invest shpk.

**16. Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplíkojë shoqëria Pogradeci Invest shpk, për vitin 2026.

**17. Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 8 Ha e 5543 m2 ,e ndodhur në Njësinë Administrative Cërravë që mund të jepen me qira.

**18. Informacion nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës në lidhje me punën e kryer gjatë periudhës Janar-Prill 2026, sfidat, sukseset dhe planet në vazhdim për vitin 2026.**

**19. Të tjera.**



**Mbledhje e Këshillit Bashkiak**

**Pogradec më 30.04.2026**

**Znj. Kryetare:** Jemi mbledhur sot në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, të njoftuar sipas ligjit nr. 139/2015, neni 53, pika 4. Ju lutem të verifikojmë prezencën.

**Znj. Bojko:** Janë prezent 22 këshilltarë. Mbledhja deklarohet e hapur.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**1. Projekt – Vendim: Miratimi i Rendit të ditës.**

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me rendin e ditës. Ju bëj me dije se, me vendim të Kryesisë, projektvendimi nr. 7 kalon për konsultim publik. Gjithashtu, edhe projektvendimet nr. 14 dhe nr. 17 kalojnë për konsultim publik. Atëherë, nëse jemi dakord dhe nuk ka diskutime për axhendën, e hedhim në votim.

**Vjen Albana Prifti Ora 12:05**

**U votua**

**Pro** 23

**Kundër** 0

**Abstenim** 1 (E.Mancellari)

**Miratohet** Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

2. Projekt – Vendim :Miratimi i Procesverbalit të datës 30.03.2026.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë atëherë me pikën e dytë të rendit të ditës. Nëse jemi dakord, e hedhim në votim. Ju lutem.

U votua

Pro 24

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**3. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.**

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. E kemi shënuar në axhendë për të mos harruar që këshilltarët të shprehin konfliktin e interesit, nëse ka. Çdokush është i lirë të deklarojë konfliktin e interesit.

**Z. Shyti:** Deklaroj konflikt interesi për pikat 15 dhe 16.

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Z. Shyti', located in the bottom right corner of the page.


Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 30.03.2026.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës. Lexohet konfirmimi nga Prefektura.

Vjen Znj.Shuli Ora 12:17

A handwritten signature in black ink, appearing to be the initials 'J.B.' or similar, located in the bottom right corner of the page.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**5. Projekt – Vendim:** Për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondit 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Mars 2026.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës. A kemi diçka, të nderuar kolegë?

**Znj. Luljeta:** Ju lutem, një sqarim. Për muajin mars 2026 janë rekomanduar rreth 20 familje. Procedura është po e njëjtë.

**Znj. Kryetare:** A kemi diçka tjetër? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është dakord?

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



**6. Projekt – Vendim:** Për “Detajimin dhe përdorimin e fondit të Kushtëzuar për mbrojtjen civile 2026”

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e radhës. Ju lutem, një informacion nga Z. Torra.

**Z. Torra:** Pranë Bashkisë së Pogradecit kanë ardhur shkresat përkatëse. Në relacionin që kam dërguar për projektvendimin, kemi vendosur që fondi të shpërndahet për familjet sipas radhës kronologjike të ndodhjes së fatkeqësisë.

Kuptohet që fondi duhet të jetë më i madh, pasi kjo shumë nuk e përballon vlerën totale, e cila është rreth 11 milion lekë. Me çeljen e pjesës tjetër të fondit, ai do të përdoret vetëm për shlyerjen e familjeve të dëmtuara.

Shuma aktuale në dispozicion nuk e përballon të gjithë vlerën, por pagesat do të bëhen sipas radhës dhe kronologjisë së ndodhjes së fatkeqësisë.

**Znj. Kryetare:** E diskutuam edhe në komision. Është mirë që të shtohet në relacion se pagesa do të bëhet sipas radhës, në mënyrë që të jetë e qartë.

**Z. Hazhillari:** Ne si komision duhet ta sqarojmë që të ndiqet një kriter, meqenëse fondet nuk i përmbushin të gjithë të dëmtuarit. Kriteri është sipas datave, siç u theksua.

**Znj. Kryetare:** Kush është dakord? E hedhim në votim.

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



**7. Projekt – Vendim:** Për disa shtesa në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.101, datë 31.10.2025 “Për miratimin e hartës së përgjithshme të plazheve të lejuara në territorin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026”

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Ia japim fjalën Znj. Enjela.

**Znj. Enjela:** Në hartën që kemi miratuar janë përcaktuar vetëm vijëzimet se ku do të ndalojnë varkat me motor uji. Në bazë të kërkesave që na kanë ardhur nga disa individë, janë vendosur trevendbazime, të cilat janë pozicionuar në dy krahët e dy urave dhe një tek motorpompën, në fund. Kjo bëhet për të mundësuar ndalimin e tyre, pasi policia kufitare nuk i lejon të ndalojnë në çdo vend sipas dëshirës, por duhet të jenë të përcaktuara.

**Znj. Kryetare:** Hartat janë të bashkëlidhura në projektvendim. Pra, bëhet fjalë për tre vende, tre pozicione për vendparkim.

**Znj. Kryetare:** Kush është dakord? E hedhim në votim.

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**8. Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihmë financiare për znj.E.P.

Znj. Kryetare: Vazhdojmë me pikën e radhës. I urojmë një shërim të shpejtë. E kemi vendosur me iniciale për të ruajtur anonimitetin. Materialet i keni secili përpara. Bëhet fjalë për një arsye shëndetësore, ndaj edhe njëherë i urojmë shërim sa më të shpejtë. Besoj se nuk ka diskutim.

E hedhim në votim. Ju lutem, kush është dakord?

Pro	25
Kundër	0
Abstenim	0

Miratohet Po Jo



**9. Projekt – Vendim:** Për miratimin e zgjatjes të periudhës së ngrohjes në institucionet arsimore të Bashkisë Pogradec.

**Znj. Kryetare:** Të gjithë e kemi ngritur këtë shqetësim. E kanë ngritur edhe prindërit, edhe nxënësit, ashtu siç e shohim edhe në relacion, si dhe kolegët e nderuar.

**Znj. Biba:** Faleminderit. Po flas për situatën konkrete. Nëse vini sot në shkollën tonë, është ftohtë. Edhe pse zgjatja u realizua për muajin prill, përsëri mbetet ftohtë. Ne kemi mundësi të ndezim ngrohjen, por kur kemi kërkuar nga institucionet, na është kthyer përgjigja se ka një afat të përcaktuar dhe nuk mund të ndizet jashtë këtij afati, nëse nuk ka një udhëzim të posaçëm.

**Znj. Kryetare:** Duhet të merret një specialist për ta përcaktuar këtë.

**Z. Kryetari:** Ne e kemi realizuar dhe janë dhënë urdhra që ngrohja nëpër shkolla të ndizet sa herë që është e nevojshme.

**Znj. Kryetare:** Patjetër, por duhet të përcaktohet mënyra. Duhet të vendoset një temperaturë minimale, ku ambienti i brendshëm të jetë në një nivel të caktuar.

**Znj. Biba:** Mjafton që të ketë karburant të mjaftueshëm.

**Znj. Prifti:** Duhet të shpërndahet në mënyrë të barabartë për vitin tjetër dhe të shihet me më shumë prioritet, pasi Pogradeci është vend i ftohtë. Nuk është e tolerueshme që fëmijët të kenë ftohtë gjatë gjithë vitit.

**Znj. Kryetare:** Ju lutem të respektojme njëri-tjetrin. Duhet një specialist për ta përcaktuar këtë. Nuk mund ta lëmë vendimin në mënyrë subjektive. Duhet të përcaktohet një kufi temperature, ku nëse bie nën atë nivel, të ndizet ngrohja. A ka ndonjë specialist prezent për ta përcaktuar?

**Z. Babasuli:** Më falni, por përcaktimi nuk mund të bëhet në këtë mënyrë. Mendoj që duhet të vendoset një afat dhe të bëhet një vlerësim mesatar, pasi nuk mund të bazohemi vetëm në temperaturë momentale.

**Znj. Kryetare:** E kalojmë në votim, ashtu siç është në projektvendim.

Vjen Z.Qeva Ora 12:25

Pro 26

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



**10. Projekt – Vendim:** Për miratimin e distancave sipas rrugëve të reja të transportit rrugor rrethqytetës të udhëtarëve dhe linjave të transportit për punonjësit arsimorë, të nxënësve të arsimit parashkollor, profesional, parauniversitar dhe të studentëve të Bashkisë Pogradec, si dhe miratimin e linjës së re Lagjia Lazishtë Velcan- Shkolla Bishnicë për transport nxënës.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Kolegë, ju lutem, mos i mbyllni mikrofonat. Ia japim fjalën Z. Shtupa.

**Z. Shtupa:** Drejtoria Arsimore kërkon vazhdimisht miratimin e linjave të reja për nxënësit, shtesa apo ndryshime të distancave sipas shkollave, për transportin e nxënësve dhe mësuesve. Në vendimin e vitit 2024 është bërë miratimi i të gjitha linjave, distancave dhe tarifave. Kërkesa e Drejtorisë Arsimore është që të bëhet një shtesë për transportin e nxënësve në pjesën e sipërme të Velçanit, ku distanca ishte 5 kilometra. Kjo shtesë do të konsiderohet si linjë e re për nxënësit. Sa i përket distancës, kërkesa është që të përcaktohet në bazë të rrugës së re në Mokër. Matja është bërë për të përcaktuar sa më saktë distancën dhe kategoritë e rrugës. Nëse ka ndonjë pyetje, jam i gatshëm.

**Znj. Kryetare:** Kolegë, a kemi pyetje? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është dakord?

Pro	26
Kundër	0
Abstenim	0

Miratohet      Po      Jo



**11. Projekt – Vendim:** Për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM” SH.A tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e ekonomisë të mbetjeve” sha.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës. Ju faleminderit. Ia japim fjalën Znj. Erinda.

**Znj. Erinda:** Përshëndetje të gjithëve. Po ju paraqis sot projektvendimin, i cili parashikon një unifikim vendimarrjeje për kthimin e AK SH.A. si një shoqëri 100% shtetërore.

**Znj. Kryetare:** Edhe ne, si Këshill, kemi marrë një shkresë për shkak të ndryshimeve ligjore. Atëherë, I japim të drejtën Kryetarit të na përfaqësojë.

**Z. Pikuli:** Kur ka ardhur kjo shkresë?

**Znj. Kryetare:** Po ju lexoj shkresën.

**Z. Pikuli:** Kjo do të thotë që është miratuar?

**Znj. Kryetare:** Shkresa është njoftim për miratim. Na njoftojnë në bazë të kuadrit ligjor.

**Z. Kryetari:** Aksionerë kemi qenë dhe mbetemi.

**Z. Pikuli:** Nuk është problem kjo pjesë. Pyetja është: a do të përmirësohet vërtet shërbimi?

**Z. Kryetari:** Kjo nuk varet nga ne.

**Z. Pikuli:** Pa bërë një analizë se si do të funksionojë, mua më intereson mënyra e shërbimit. Nëse të gjitha mbetjet do të shkojnë në Tiranë, atëherë a do të përmirësohet ky shërbim? Nga eksperiencia që kemi, e dimë shumë mirë që këto lëvizje nuk kanë funksionuar. Kush na siguron ne, si Këshill Bashkiak i Pogradecit, që kjo do të funksionojë?

**Z. Kryetari:** Deri tani si ka funksionuar dhe si ka qenë, pritet të përmirësohet. E hedhim në votim.

**Znj. Kryetare:** Po krijojmë një debat të pavend. Shkresa ka ardhur për shqyrtim.

**Z. Kryetari:** Ne mendojmë për më mirë.

**Z. Pikuli:** Ne duam argumente pse mendoni që është për më mirë. Nëse është për më mirë, urime.

**Z. Kryetari:** Duhet të shohim edhe mundësinë tonë. A kemi mundësi ta bëjmë në Pogradec? Nuk na detyron askush, por ne nuk e kemi mundësinë. Shpenzimet janë shumë të larta, rreth 220 mijë euro në vit.



**Z. Pikuli:** Ne duam vetëm të dimë nëse do të përmirësohet.

**Znj. Kryetare:** A ka dëshirë të flasë dikush tjetër? Nëse jo, e hedhim në votim.

**Pro** 20  
**Kundër** 4 (A.Prifti, F.Pikuli, K.Gjona, M.Biba)  
**Abstenim** 2 (A.Male, E.Mancellari)

Miratohet Po Jo

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Jub' or similar, written in a cursive style.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

**12. Projekt – Vendim:** Për miratimin e dhënies me qira, për vendosjen antene të telefonisë të lëvizshme në favor të kompanive one Albania SH.A në sipërfaqe, 160 m2 në pasurinë 665 zk 2042 Kalivac, Trebinjë dhe Vodafone Albania SH.A sipërfaqen 100 m2 në pasurinë 213/6 zk 3753 Vërrë, Proptisht.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën e radhës. Kishte kolegë që ishin edhe në konsultimin publik që u zhvillua në dy fshatra. Banorët e dëshirojnë, pasi është në të mirën e tyre.

**Z. Kryetari:** Kompanitë përkatëse e kanë për detyrë që në zonat ku operojnë të kontribuojnë në të mirë të komunitetit.

**Znj. Kryetare:** Ia japim fjalën Z. Xhyra.

**Z. Xhyra:** Konsultimi u bë me sukses. Të gjithë banorët ishin dakord në të dyja fshatrat ku ne morëm pjesë. Ata vetë e kanë kërkuar, me përjashtim të një banori që paraqiti shqetësim, pasi ishte pronar i një pjese toke.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim. Kush është dakord?

Pro 25

Kundër 0

Abstenim 1 (E.Mancellari)

Miratohet Po Jo



**13.Projekt – Vendim:**Për rishqyrtimin e tarifave të administrimit për ndërtesat që do të administrohen nga Shoqëria Pogradec Invest shpk.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me pikën tjetër. Pika 14, ashtu siç e përmendëm, kalon për konsultim publik. Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

**Z. Cela:** Përshëndetje. Kemi sjellë dy projektvendime.

**Znj. Kryetare:** T'i marrim me radhë, të lutem.

**Z. Cela:** Sa i përket administrimit të pallateve, aktualisht kemi vetëm shërbimin që kryejmë për pallatet ku banorët na kanë zgjedhur. Tarifa mbetet e njëjtë.

**Znj. Kryetare:** Me radhë, jemi tek administrimi i pallateve.

**Z. Cela:** Për pjesën e ashensorëve nuk kemi filluar ende, për arsye se nuk kanë dalë aktet nënligjore. Kemi kërkuar informacion nga kompanitë që operojnë aktualisht dhe presim përgjigjen e tyre. Shërbimi duhet të vazhdojë, sepse banorët e kërkojnë dhe ne do të vazhdojmë siç kemi qenë deri tani. Tarifa është 500 lekë në muaj për familje dhe nuk ka asnjë ndryshim në pagesë.

**Z. Kryetari:** Për pallatet që nuk kanë administrim, si e keni menduar?

**Z. Cela:** Ne jemi një shoqëri administrimi dhe shkojmë në çdo pallat ku kemi konfirmimin nga banorët.

**Z. Kryetari:** Mund të mblihen 10–15 pallate dhe zgjidhjen ta bëjnë vetë.

**Z. Cela:** Ligji është i qartë. Nëse banorët nuk arrijnë të ngrenë kryesinë, në rastin konkret vendosni ju si Kryetar Bashkie dhe përcaktoni kush do të administrojë.

**Z. Kryetari:** Ju duhet t'i kishit vendosur këto.

**Z. Cela:** Po, por ende nuk kanë dalë aktet nënligjore, prandaj ndodhemi në këtë situatë.

**Znj. Silvana:** Më falni, por në një pallat të ri jetojnë vetëm 4 familje. Me familjet e tjera si do të procedohet?

**Z. Cela:** Nuk ka rëndësi, pasi shërbimi do të kryhet njësoj si për ata që janë prezent, ashtu edhe për ata që nuk janë. Brenda vitit ata do të kthehen, por kanë detyrim ligjor që pagesa duhet kryer.



Bashkia thjesht ndihmon situatën në momente të vështira për shoqërinë, ndërsa detyrimet do të paguhen ose nga vetë familjet, ose nëpërmjet bankës.

**Z. Kryetari:** Mirë do të ishte të gjenim një zgjidhje, ose me ujësjellësin, ose me energjinë elektrike.

**Z. Babasuli:** Ligji parashikon që, në mungesë të banorëve, nëse brenda vitit ata nuk paraqiten, ekziston e drejta që të vendoset barrë detyrimi në hipotekë për detyrimet e pallatit. Në momentin kur pallati nuk përzgjedh një kryesi, këtu ndërhyt bashkia dhe e zgjidh situatën, por aktualisht kemi problemin e akteve nënligjore që ende nuk kanë dalë. Për sa i përket kostove aktuale, është bërë një parashikim dhe jemi në rregull. Bëhet fjalë për pallatet pa ashensor. Për pallatet me ashensor do të kemi një fazë të dytë. Edhe për pjesën e ashensorëve do të rikthehemi me një fazë tjetër, pasi jemi në diskutim me kompanitë operuese për mënyrën e procedimit.

**Z. Cela:** Disa pallate që i kemi aktualisht në administrim janë shumë të kënaqur. Banorët kanë ardhur në zyrë dhe po na kërkojnë përsëri për administrim. Në çdo rast që ata nuk janë dakord me punën tonë, ne largohemi dhe ata kanë të drejtë të zgjedhin shoqërinë që dëshirojnë.

**Znj. Biba:** Mesa di unë, janë edhe dy shoqëri të tjera. Si do të operoni?

**Z. Cela:** Duhet të ngrihet kryesia, e cila përbëhet nga tre persona, dhe në momentin që ata na zgjedhin ne, bëjmë kontratën. Çdo shqetësim që ata kanë, ne mundohemi ta zgjidhim dhe deri tani çdo problematikë është trajtuar në kohë.

**Znj. Biba:** Shumë pallate, kur dëgjojnë për projektvendimet, pyesin për procedurat.

**Z. Cela:** Ne nuk mund të shkojmë pa u ngritur më parë kryesia dhe të ofrojmë shërbim.

**Z. Babasuli:** Më falni, nëse kryesia e pallatit ka zgjedhur "Pogradeci Invest", atëherë shoqëria ka të drejtë të kryejë shërbimet. Problemi mbetet tek ato pallate që kanë pak familje dhe nuk mund të ngrenë kryesinë. Në atë rast, kompetencat i kalojnë bashkisë dhe më pas bashkia përcakton kompaninë që do të merret me mirëmbajtjen e pallatit. Aktualisht jemi në fazat e para dhe kemi rreth 27 godina, ndërkohë që në total janë 105 pallate me ashensor. Kemi tentuar të mësojmë edhe pjesën e ashensorëve. Jemi ende në proces përmirësimi dhe po trajtohen një nga një. Jam i sigurt që situata do të përmirësohet dita-ditës. Nëse ka shqetësime për pjesën e administrimit, duhet të përshpejtojmë edhe procedurat.

**Z. Cela:** Informacionet janë dhënë, si edhe numri i telefonit. Banorët kanë ardhur edhe në zyrë dhe janë informuar gjerësisht. Gjithashtu do të dalim edhe me një njoftim tjetër.

**Z. Kryetari:** Ndoshta duhet të bëni mbledhje dhe t'i informoni. Kjo duhet bërë.

**Z. Cela:** Kemi bërë njoftime në çdo pallat, por ka raste kur banorët nuk pranojnë, pasi e pastrojnë vetë shkallën. Ndërkohë, pa dalë aktet nënligjore, ne nuk mund të veprojmë më tej. Aty ku ka pasur raste konkrete dhe kanë kërkuar shoqërinë tonë, ne u jemi përgjigjur.



**Znj. Seitllari:** Kam të njëjtin shqetësim. Kemi nevojë për më shumë informacion lidhur me kërkesat dhe çfarë shërbimesh do të ofroni konkretisht.

**Z. Cela:** Në fillim paraqitet kërkesa dhe më pas kërkohet administrimi. Ideja është që, pa na zgjedhur ne, nuk mund t'u përgjigjemi apo të tregojmë konkretisht çfarë mund të bëjmë. Brenda 6 muajve, nëse ne nuk ofrojmë shërbimin e duhur, ata kanë të drejtë të zgjedhin një kompani tjetër. Por pa administrim nuk mund të qëndrohet, sepse është detyrim ligjor.

**Z. Gjona:** Ky projektvendim ka ardhur edhe më parë dhe arsyeja kryesore që nuk kaloi ishte mungesa e akteve nënligjore. Ato kanë dalë tani?

**Z. Cela:** Aktet nënligjore ende nuk kanë dalë, por ne duhet të vazhdojmë punën me kuadrin aktual dhe më pas do të merremi me pjesën tjetër.

**Z. Babasuli:** Duhet të jetë tarifa e aprovuar.

**Z. Gjeno:** Kisha një pyetje për pallatet që nuk kanë ashensor. Si mund të veprohet?

**Z. Cela:** Aty ku ne jemi në administrim, bëjmë projektin, e paraqesim në urbanistikë, bëhet konfirmimi dhe, nëse ka mundësi teknike, realizohet.

**Z. Babasuli:** Këtë investim mund ta bëjë edhe vetë banori, nuk e ndalon askush. Nuk është pjesë e administrimit vendosja e ashensorit. Detyrimi ynë është mirëmbajtja, pastërtia dhe funksionimi i tij. Kjo kosto nuk parashikohet në administrimin e pallatit, sepse vendosja e ashensorit është zgjedhje e vetë banorëve.

**Z. Mancellari:** Nga eksperiencia, kjo është diçka shumë e domosdoshme për komunitetin. Përveç orarit zyrtar, duhet të jeni në dispozicion të banorëve dhe të përgjigjeni për problematikën, sidomos në periudhën e dimrit, kur nevojiten shërbime shtesë. Gjithashtu, për familjet me një ose dy persona, si do të jetë pagesa? A do të jetë fikse apo më e ulët?

**Z. Babasuli:** Kjo mbetet për t'u diskutuar. Qëllimi i "Pogradeci Invest" është të kemi pallate të pastra, të ndriçuara dhe ashensorë funksionalë. Në momentin që do të kemi kostot reale, mund të kërkojmë tarifa më të ulëta për kategori të ndryshme. Ende nuk kemi bërë një kalkulim për tarifën e diferencuara, por kjo do të trajtohet në një fazë tjetër.

**Z. Mancellari:** Mendoj që kjo duhet parë që në fillim, në mënyrë që të gjithë të jenë të informuar. Një pension i dalë para vitit 2000 nuk është më shumë se 18 mijë lekë të reja dhe me atë shumë është e vështirë të përballohen tarifën. Duhet të ketë një tarifë minimale, për shembull 200 lekë në muaj.

**Z. Babasuli:** Siç e thamë, kjo do të vijë si pasojë e punës në vazhdim.



**Z. Cela:** Nga banorët që kemi pasur deri tani, shumica thonë: “Vetëm të mirëmbahen dhe jemi gati të paguajmë edhe pak më shumë”.

**Z. Pikuli:** A keni ndonjë pasqyrë financiare të “Pogradeci Invest”? Nëse po, vendoseni në dispozicion. Është një alternativë për qytetarët dhe duhet të dimë nëse banorët janë të kënaqur. Gjithashtu, nëse ka kontrata, sillini për shqyrtim.

**Z. Haxhillari:** Na ka ardhur një projektvendim për miratimin e tarifave të administrimit. Kjo shoqëri ende nuk është e kompletuar për mënyrën se si do të funksionojë. Pasi ta miratojmë dhe të fillojë puna, më pas do të kërkojmë llogari për rezultatet dhe mënyrën e funksionimit.

**Z. Male:** A jeni të gatshëm të sillni një pasqyrë financiare mes të ardhurave dhe shpenzimeve? Pra, a arrin “Pogradeci Invest” të mbulojë shpenzimet e veta apo vazhdon të marrë financime nga bashkia?

**Z. Cela:** Pasqyrën financiare e kemi. Në momentet kur kemi pasur vështirësi financiare, normalisht kemi marrë ndihmë nga bashkia. Në vitin 2025 kemi marrë rreth 5 milion lekë të reja.

**Z. Male:** Atëherë jeni me bilanc negativ. Për çfarë i duhet Pogradecit një shoqëri që rëndon mbi taksat e qytetarëve? Për sa vite mendoni se do të arrini të balanconi situatën?

**Z. Cela:** Ju garantoj që këtë vit nuk do të jemi të varur nga bashkia.

**Z. Kryetari:** Ne fillimisht e krijuam për parkimet, për të vendosur rregull. Ndërkohë po i japim edhe këtë mundësi.

**Znj. Prifti:** Dy herë në javë pastrim nuk mjafton. Në apartamentet ku jetojmë, edhe një llambë kërkon kohë për t’u ndërruar. Gjithashtu, lysterja është përcaktuar një herë në dy vjet, ndërsa pastrimi duhet të jetë të paktën katër herë në javë.

**Z. Cela:** Prandaj ekzistojnë disa kompani. Nëse një kompani tjetër ofron pastrim tre apo katër here në javë, normalisht banorët do ta zgjedhin atë. Por aktualisht kjo është mundësia jonë.

**Znj. Kryetare:** Atëherë, kolegë, e hedhim në votim. Kush është dakord?

**Pro** 18

**Kundër** 4 (L.Seitllari,A.Male,K.Gjona,A.Prifti)

**Abstenim** 3 ( E.Mancellari, F.Pikuli, M.Biba)

**Miratohet** Po Jo



14. Për rishqyrtimin e tarifave të parkimeve që do të aplikojë shoqëria Pogradeci Invest shpk, për vitin 2026.

**Znj. Kryetare:** Vazhdojmë me projektvendimin e radhës.

**Z. Male:** Ky projektvendim, pak a shumë, është i njëjtë me atë që sollët herën e parë, për të cilin ne votuam kundër dhe patëm një dakordësi mes nesh. Mendoj se ky projektvendim është i dëmshëm për qytetin tonë dhe do të krijojë problem për qytetarët. Rritja e tarifave në rrugët kryesore do të bëjë që qytetarët të dynden në rrugët dytësore dhe ne e dimë shumë mirë si janë lagjet e Pogradecit. Ky është argumenti I parë. Së dyti, këtë rritje do ta vuajnë banorët e njësisive administrative, sepse nga njëra anë nuk kanë të drejtë të parkojnë në lagje pasi nuk janë rezidentë, ndërsa nga ana tjetër parkimi me 100 lekë ora do të thotë një kosto prej rreth 500 lekësh të reja për mbi 5 orë qëndrimi në Pogradec, gjë që është relativisht e lartë. Së treti, si do t'i presim turistët? Korça aktualisht e ka parkimin 100 lekë dita. Një turist që qëndron 24 orë do të paguajë 2400 lekë parkimin dhe 3000 lekë hotelin.

**Z. Cela:** Nuk funksionon në këtë mënyrë. Orari është nga ora 08:00 deri në 18:00.

**Z. Male:** Sa orë janë? Tetë orë.

**Z. Cela:** Më fal, por kur shkon me pushime, nuk paguan parkim?

**Z. Male:** Po, por paguaj 200 lekë nata.

**Z. Cela:** Edhe këtu paguhet, ndërsa në disa hotele parkimi ofrohet falas. Nuk më rezulton që në ndonjë vend parkimi të jetë 200 lekë. Gjithashtu, ka edhe keqinformim, sepse rritja është sezonale, nga 15 qershori deri më 15 shtator.

**Z. Male:** Si do ta disiplinoni ju trafikun?

**Z. Cela:** Ky është disiplinimi. Bëhet fjalë vetëm për një rrugë kryesore dhe jo për të gjithë qytetin. Vetëm një rrugë do të jetë me pagesë, ndërsa pjesa tjetër mbetet siç ka qenë.

**Z. Male:** E dini çfarë ngarkese do të ketë ajo rrugë? Të gjithë do të dynden nëpër lagje. Pse nuk funksionon pulla e rezidentit?

**Z. Cela:** Ai që ka pullë rezidenti nuk do të paguajë.

**Z. Male:** Mendoj se kjo shoqëri nuk i duhet Pogradecit. Punën e bën policia bashkiake dhe policia e shtetit. Mos e përdorni si argument disiplinimin e trafikut, sepse Pogradeci është qytet i vogël dhe të gjithë njihen me njëri-tjetrin. E kam ngritur edhe tre muaj më parë shqetësimin për parkimet e zëna në mënyrë abuzive. Çfarë masash keni marrë si shoqëri për këtë problematikë?

**Z. Cela:** Duhet të paraqitet shqetësimi konkret. Aktualisht janë rreth 60 parkime që janë paguar.

**Z. Male:** Për kohëzgjatjen, si e keni menduar?

**Z. Cela:** Me këtë projektvendim që kemi sjellë, nëse parkimin e dëshironi nga e hëna në të premte, tarifa mbetet 36 mijë lekë, siç ka qenë. Nëse e dëshironi 24 orë, nga e hëna deri të hënën tjetër, tarifa është 72 mijë lekë. Gjithashtu, kemi parashikuar edhe tarifa 6-mujore për banorët që kanë kërkesa sezonale, jo për bizneset. Kjo është sqaruar qartë.

**Znj. Kryetare:** Unë personalisht, kolegë, do t'ju bëja thirrje të merrni pjesë në komisione. Këtë herë kishte shumë pak pjesëmarrje në komisione, ndërkohë që aty jepen mendimet dhe zhvillohen diskutimet kryesore. Ka shumë detaje që diskutohen në komisione. Ju lutem, merrni pjesë dhe mbani përgjegjësi.

**Z. Male:** Kjo do të thotë që nuk duhet të flasim?

**Znj. Kryetare:** Jo, nuk do të thotë që nuk duhet të flisni, por jo kaq gjatë dhe jo me kaq shumë detaje. Detajet diskutohen në komisione.

**Z. Mancellari:** Nëse bëhet fjalë për dy rrugët që kanë fluksin më të madh në qytetin e Pogradecit dhe pagesa do të jetë 100 lekë, do të sugjeroja që të shtohet për turistët, por me kusht që qytetarët e Pogradecit të mos paguajnë. Gjithashtu, do të donim një hartë të qartë ku të përcaktohen rrugët dhe zonat publike e private. Pse të mos përfshihen edhe Tushemishti, pjesa e liqenit në Starovë apo Lin, pasi edhe ato zona kanë fluks? Unë jam dakord ta votoj këtë projektvendim, por me kusht që qytetarët e Pogradecit të mos kenë pagesë.

**Znj. Zhaneta:** Kemi diskutuar vazhdimisht edhe në komisione që rruga industriale të mos preket, pasi është shumë e mbingarkuar nga trafiku. Shqetësimi është që të mos ketë parkime në atë aks dhe rruga të funksionojë me dy kalime, në të mirë të qytetarëve.

**Z. Cela:** Edhe unë e kam kërkuar këtë. Deri në momentin që rruga është me një kalim, mund të ketë parkim, por në momentin që bëhet me dy kalime, nuk mund të ketë parkim.

**Znj. Kryetare:** E diskutuam edhe herën e kaluar. Ju lutem, të mos përsërisim të njëjtat diskutime.

**Znj. Shuli:** Ju përshëndes të gjithëve. Ne jemi të detyruar të paguajmë shërbimet, pasi është një shërbim që paguhet kudo. Jam dakord me atë që tha Z. Mancellari, që të përfshihen edhe zonat e tjera turistike, si Tushemishti apo Lini, dhe parkimet të jenë me tarifë 50 lekë. E vetmja gjë që më shqetëson është se kam marrë telefonata nga bizneset lidhur me faktin që tarifa e bizneseve është e njëjtë me atë të hoteleve. Hotelet paguajnë një numër të konsiderueshëm punonjësish, por edhe bizneset kanë shpenzime të ngjashme. Si është bërë kjo ndarje? Vitin e kaluar tarifa ka qenë 36 mijë lekë të reja për gjithë vitin, ndërsa sivjet rritet me 100%. Në relacion thuhet se fundjavat përjashtohen, ndërkohë që bizneset punojnë pikërisht në fundjavë. Për mua kjo duhet të



rishikohet dhe të lihet siç ka qenë. Kjo është edhe kërkesa e bizneseve, të cilat shprehen se nuk kanë qenë në dijeni gjatë konsultimit publik.

**Znj. Kryetare:** Njoftimi është bërë edhe në faqen e Këshillit.

**Znj. Shuli:** Jo të gjithë janë të orientuar me rrjetet sociale.

**Z. Cela:** Ashtu siç kanë operuar edhe qytetet e tjera në Shqipëri, shërbimi nuk mund të jetë i njëjtë në çdo rast. Qyteti duhet të ketë akses dhe biznesi e përdor parkimin gjatë gjithë ditës. Pas orës 18:00 parkimi lirohet.

**Znj. Shuli:** Nuk jam kundër rritjes, por rritja duhet të jetë graduale dhe jo progresive.

**Z. Babasuli:** Ekziston edhe tarifa 6-mujore, e cila është kërkuar kryesisht nga hotelet.

**Znj. Shuli:** Tarifat janë të ndara në grafik.

**Z. Babasuli:** Kështu funksionojnë parkimet, të ndara sipas kategorive. Nuk e bëjmë ne këtë ndarje, është mënyra standarde e funksionimit.

**Z. Cela:** Në rastin konkret, shëtitorja funksionon me pagesë deri në orën 18:00.

**Znj. Kryetare:** A ka dikush tjetër që dëshiron të flasë? Kolegë, të sqarojmë diçka që të mos ketë dezinformim. Tarifat janë lexuar dhe hartat janë të bashkëlidhura. E kam kërkuar edhe herën e kaluar që të jemi të qartë.

**Z. Gjona:** Do të risjell shembullin që përmenda edhe herën e parë. Një familje pogradecare paguan rreth 150 mijë lekë të vjetra për shërbimet që ofron bashkia dhe duhet të paguajë edhe 360 mijë lekë parkim. Kjo është ajo që po miratojmë sot. Së dyti, unë jam nga ata banorë që vij nga rrethinat dhe punoj në Pogradec. Edhe tarifa 50 lekë është problem për ne, pasi aq janë pagat, jo më të bëhet 100 lekë. Ju bëj thirrje që të mos e kalojmë këtë projektvendim.

**Z. Babasuli:** Ne nuk kemi vetëm parkime me pagesë, por edhe parkime pa pagesë. Kjo do të thotë që po përpiqemi të disiplinojmë situatën. Ai që ka mundësi, zgjedh parkimin me pagesë. Nuk mund të ketë parkim falas para çdo biznesi.

**Znj. Kryetare:** E hedhim në votim. Kush është dakord?

**Znj. Kryetare:** Vetëm një gjë do t'ju kërkoja: të lajmërohen banorët, të afishohen tabelat dhe të jepet informacioni i nevojshëm.

**Pro** 18

**Kundër** 4 (L.Seitllari,A.Male,K.Gjona,A.Prifti)

**Abstenim** 2 ( E.Mancellari, F.Pikuli, M.Biba)

**Miratohet** Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 30.04.2026

15. Informacion nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes dhe Infrastrukturës në lidhje me punën e kryer gjatë periudhës Janar-Prill 2026, sfidat, sukseset dhe planet në vazhdim për vitin 2026.

Znj. Kryetare: Gjithashtu, kemi kërkuar nga ndërmarrja të paraqesë informacion mbi punën e kryer për periudhën janar-prill 2026, pasi kolegët kanë pasur kërkesa dhe ankesa.

E deklaroj mbledhjen të mbyllur. Ju faleminderit.

Protokolli:

Suela Merikola



Muratovi

Sekretare e Këshillit

Jona Bojko

